

Vaksina plotësuese kundër koronavirusit



Vaksina ju mbron me sukses kundër koronavirusit.




Ndoshta e keni marrë tashmë vaksinën tuaj kundër koronavirusit.




Pas pak muajsh, vaksina nuk do të funksionojë dhe aq mirë. Kjo është arsyeja pse më e mira është që të bëni një vaksinë suplementare. Injeksioni suplementar




Vaksina plotësuese rrit imunitetin tuaj dhe ju mbron që të mos sëmurëni rëndë.




Nëse shumë njerëz e bëjnë vaksinën plotësuese, do të sëmurën më pak njerëz.



Në këtë mënyrë, do të ketë shtretër të mjaftueshëm në spital për t'u kujdesur për të gjithë personat e sëmurë.



Me një vaksinë plotësuese, nuk është nevoja të bëni test për koronavirusin pas një kontakti me rrezik të lartë.




Me një vaksinë plotësuese, nuk është nevoja më që të karantinoheni pas një kontakti me rrezik të lartë. Por, tregohuni të kujdesshëm.




Vaksina plotësuese rekomandohet gjithashtu edhe pas infektimit me koronavirus për të rritur imunitetin tuaj.



Kur të vijë radha juaj për vaksinë plotësuese, personeli në qendrën e pritjes do t'ju informojë. Mos e humbisni takimin tuaj!



Pas vaksinës suaj plotësuese, duhet sërish të ndiqni rregullat: mbani distancën, mbani maskë fytyre, ajrosni dhomat dhe lajini duart rregullisht.



Dhe testohuni nëse keni simptoma të koronavirusit.

